

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: **OPERATORIN EKONOMIK “ALB - STAR”**  
**Fier Patos, Patos Zona Industriale, Patos**

Procedura e prokurimit: Punë/ **Procedure e Hapur**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-81470-07-31-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndertim rruga Kardhiq – Delvine, Loti 5”**, me fondin limit: **1.825.714.418,81** lekë pa TVSH. **Numri i referencës së procedurës: REF-81470-07-31-2018**  
Afati i zbatimit të kontratës 24 muaj.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve 06.08.2018] [Nr.31]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“GPG Company shpk”** J64324443V

Vlera 1.804.425.525 (nje miliard e teteqind e kater milion e katerqind e njezete e pese mije e peseqind e njezete e pese) Lekë pa përfshirë vleren e tvsh-së.

2. **“ALB - STAR”** J62903512W

Vlera 1.785.446.573,09 (nje miliard e shtateqind e tetedhjetë e pese milion e katerqind e dyzete e gjashtë mije e peseqind e shtatedhjetë e tre presje zero nente) Lekë pa përfshirë vleren e tvsh-së.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**Operatori ekonomik GPG Company shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit si më poshtë:**

Nga te dhenat qe disponon Autoriteti Kontraktor, rezulton qe operatori ekonomik GPG Company (si bashkim operatoresh) ka nenshkuar dhe ka ne zbatim kontraten me objekt "Ndertim by pass – Tepelene, Loti 1". Kjo kontrate rezulton te mos jete perfunduar ne masen mbi 70 %, ne kundershtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b, i ndryshuar, ku thuhet *"Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t'u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtatin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të s'kualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence".*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **"ALB – STAR"** me adrese **Fier Patos, Patos Zona Industriale, Patos**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1.785.446.573,09 (nje miliard e shtateqind e tetedhete e pese milion e katerqind e dyzete e gjashte mije e peseqind e shtatedhete e tre presje zero nete) lekë pa tvsh /pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Autoritetit Rrugor Shqiptar/ Sektori i Prokurimeve] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [ vlera perkatese e shprehur ne fjalar dhe shifra ], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.09.2018

Ankesa: Nuk ka

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_